



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Datë:	31.12.2017
References:	
Për :	Z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	Z. Fauz Xhemjali - Nënkyetar i Komunës Z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar për Komunitet Arkiven
Nga:	Bekim Shabani - Drejtor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
Lënda:	RAPORT MUJOR DHJETOR - 2017

I nderuar Kryetar,

Gjatë muajit dhjetor në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, Udhëzimet, Urdhëresat, Statuti dhe Rregulloret tjera komunale.

Në raportimet javore e kemi paraqitur përafërsisht punën e drejtoratit.

Zyrtarët nëpër sektorë janë angazhuar maksimalisht në kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive që kanë .

AKTIVITETET GJATË MUAJIT DHJETOR 2017

- Parapregaditja dhe kujdesi për konferencën e Hendikosit në objektin Bibliotekës dhe Arhivit të qytetit e mbajtur me 04.12.2017, një ditore,
- Mbajtja e konferencës Hendikos në objektin e DKRS-së,
- Organizimi dhe përzgjedhja e sportistit të vitit 2017,
- Pjesëmarrja në shpalljen e sportistit të vitit 2017
- Pjesëmarrje në përvjetorin e shkollës së futbollit Proff Futball dhe Roni 19
- Pjesëmarrja në Trajnimin e Menaxhimit të Ciklit të Projekteve në Programin Rajonal, për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor(ReLOaD)
- Organizimi dhe pjesëmarrja në koncertin “Tingujt Magjik” në Qendren Kulturore “Tahir Sinani” Lipjan, koncert për fëmijë (mbajtur me 28.12.2017)
- Shpërndarja e disa dhuratave femijeve të cilët performuan në koncertin “Tingujt Magjik”
- Kemi bërë vizita në terren konkretisht në fushat sportive të cilat janë në finalizim e sipër në Fsh. Gadime të Epërme dhe Gadime të Ulet

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR-- Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër për muajin raportues.

- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore,
- Kontrollimi i raporteve, arsyetimeve të projekteve të subvencionuara për vitin 2017,
- Sektori i Arkivit dhe ai i Bibliotekës janë duke ju ofruar shërbime palëve sipas kërkesave të tyre .
- Qendra Rinore Sportive në Lipjan ka punuar sipas orarit dhe kërkesave të klubeve sportive,
- Pergaditja e planit financiar,
- Pergaditja e propozimit për planin vjetor të punës.

Takimet me Palë

- DKRS-ja në vazhdimësi ka takime me qytetarë, për t'u interesuar rreth kërkesave të ndryshme dhe për t'u pajisur me pëlqime për mbajtjen e aktiviteteve,

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare;

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Procedurë	Të Pazgjidhura
4	-	1	3	-

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vërejtje
8	9	93	-	Janë inkasuar 49.50€

Tabela- 3, -- Raport për Biblotekën e Qytetit dhe Bibliotekat në Teren

Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues te rinj	Përpunim I librit	Lexus në sallën e leximit
766	857	84	187	1541

Dhjetor 2017